



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
OSNOVNI SUD U PRIZRENU – BASIC COURT OF PRIZREN

AD-GjThPZ.nr.10/22

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, kryetarja e gjykatës, Shpresa Emra, duke vepruar sipas ankesës së Avokatit B.K., nga Prizreni parashtruar kundër gjyqtarit G.Sh., gjyqtar në Gjykatën Themelore në Prizren, lidhur me veprimet dhe sjelljen e gjyqtarit të lartcekur në bazë të së cilës është bërë iniciimi i procedurës disiplinore, me dt.16.12.2022, mori këtë:

AKTVENDIM

Refuzohet si e pabazuar ankesa e Avokatit B.K., nga Prizreni parashtruar në Këshillin Gjyqësor të Kosovës kundër gjyqtarit G.Sh., gjyqtar në Gjykatën Themelore në Prizren për iniciimin e procedurës disiplinore.

Arsyetim

Parashtruesi i ankesës avokati B.K., në ankesën e parashtruar kundër gjyqtarit G.Sh., ka cekur se në veprimet e gjyqtarit të lartcekur ka pasur veprime procedurale të jashtëzakonshme dhe të qëllimshme pasi që gjyqtari G.Sh., nuk është duke trajtuar lëndët të cilët ai i përfaqëson dhe që kanë të bëjnë me shujta dhe paga jubilarë, kurse është duke trajtuar lëndët të avokatëve të tjerë e të cilat janë me datë më të re se lëndët e tij. Konkretisht gjyqtari ka trajtuar lëndët e avokates S.M.N. të vitit 2022 dhe nuk ka trajtuar lëndët e tij të viteve 2020 dhe 2021.

Kryetarja e gjykatës pasi që ka pranuar ankesën, ka inicuar hetimet për procedure disiplinore dhe ka ndërmarrë disa veprime në këtë drejtim. Fillimisht ka bërë shiqimin në ankesën e parashtruar, ka kërkuar deklaratë nga gjyqtari G.Sh., ka bërë shiqimin në dokumentacionin e parashtruar nga avokati B.K., dhe nga gjyqtari i çështjes, ka bërë shiqim në regjistër të lëndëve dhe pasi ka analizuar pretendimet ankimore, ka konstatuar se: **Ankesa është e pabazuar.**

Në rastin konkret është konstatuar është e vërtetë që gjyqtari G.Sh., ka kryer lëndët të cilët janë me padi për shujta dhe paga jubilarë të vitit 2022 të avokatëve të ndryshëm që është vërtetuar nga ana e dokumentacionit të parashtruar nga vet gjyqtari ashtu edhe nga avokati B.K.,. Të gjitha këto si objekt kontesti janë shujta ditore dhe paga jubilarë të cilat lëndë janë kryer pa shqyrtim kryesor të çështjes kur janë plotësuar kushtet, ashtu si është paraparë me ligj. Nga ky verifikim është vërtetuar se gjyqtari nuk ka kryer lëndët të cilat i ka përfaqësuar

vetëm një avokat , por disa avokat të ndryshëm me pale të ndryshëm. Gjithashtu me shiqimin e natyrës së lëndëve të cilat I përfaqëson avokati B.K., e të cilat janë tek gjyqtari G.Sh., është konstatuar se këto lëndë nuk janë të lëndë me padi për shujta dhe paga jubilarë por janë lëndë për kompensim në page në bazë të kualifikimit . Nga kjo rezulton se lëndët të cilat I përfaqëson avokati janë me natyrë tjetër dhe të njëjtat nuk janë lëndë sipas padisë për paga jubilarë Ose për shujta ashtu si pretendon I njëjti. Gjyqtari G.Sh., ka deklaruar se lëndët të cilët I përfaqëson avokati B.K., e që kanë të bëjnë me pagën jubilarë janë kryer ose janë në procedure e sipër.

Kryetarja ka vlerësuar se në rastin konkretë nuk ka pasur bazë për shkelje disiplinore në rastin konkret, respektivisht nuk janë përmbushur dispozitat nga shkeljet disiplinore për gjyqtarë të paraparë nga neni 5 i Ligjit për përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve nr.

06/1-067.

Për arsyet që u cekura më lartë, është vendosur si në dispozitiv të aktvendimit në kuptim të nenit 9 paragrafi 6 lidhur me nenin 17 paragrafi 5 të Ligjit nr.06/L-057 për përgjegjësinë dicipinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN

AD-GJTHPZ.nr.10/22 me dt.16.12.2022

Kryetarja e Gjykatës Themelore në Prizren



KËSHILLA JURIDIKE: *Kundër këtij aktvendimi nuk është e paraparë e drejta e ankesës*